REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 29/2021 (JR)** **Tiranë, më 26.04.2024**
**Nr. 29/2 regj.**

**SHPALLJE**
**E**
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën e **hënë, në datën 03.06.2024, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 29/2021 (JR), datë 28.05.2021, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 352, datë 01.03.2021.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Rezarta Schuetz** |
| **Relator i Çështjes** | **Sokol Çomo** |
| **Gjyqtare** | **Natasha Mulaj** |
| **Gjyqtare** | **Ina Rama** |
| **Gjyqtare** | **Albana Shtylla** |

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**
**GJYQTARE**
**REZARTA SCHUETZ**